



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1262/11 prot.

Datë 12.06.2026

V E N D I M
Nr. 798/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.06.2026 me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 684/2026, datë 21.05.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK, me NIPT (M41902005D) dhe adresë Njësia Administrative Nr.5, Rruga Ukraina e Lirë , Pallati Nr.1, Kati 1, Apartamenti Nr.4.
- Autoriteti Kontraktor:** Identitek Sh.a, me adresë: Rr. “Xhanfize Keko”, Ndërtesa nr. 111, Hyrja nr.1, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 21/05/2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 684/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshem i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.*
 2. *Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK sipas konstatimeve të vendimit të mësipërm të Komisionit të Prokurimit Publik.*
 3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
 4. *Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SOHO SOLUTIONS” SHPK.*
 5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit*
 6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

I.2. Me shkresën nr. 552/17 prot., datë 08.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1262/8 prot., datë 10.06.2026, autoriteti kontraktor Identitek Sh.a., ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 684/2026 datë 21/05/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshem i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 552/17 prot., datë 08.06.2026, protokolluar me tonën nr. 1262/8 prot., datë 10.06.2026, autoriteti kontraktor Identitek Sh.a., ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 684/2026 datë 21/05/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi sipas vendimit nr. 684/2026 datë 21/05/2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorin ekonomik duke zbatuar kështu vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79360-03-17-2026, me objekt: “Auditim i Brendshëm i ISMS sipas Standartit ISO 27001:2022”, me fond limit 1,733,333.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30-03-2026, nga autoriteti kontraktor, Identitek Sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

